

MILIONAT E SHPENZUARA PËR MONUMENTET E MBYLLURA



Organizata Jo-qeveritare
EC Ma Ndryshe
Shkurt, 2016

MILIONAT E SHPENZUARA PËR MONUMENTET E MBYLLURA



Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “EC për qytete transparente dhe gjithëpërfshirëse”, i përkrahur financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur. Përmbajtja dhe qëndrimet e shprehura në këtë publikim i përkasin autorëve dhe organizatës jo-qeveritare EC Ma Ndryshe.

Rr. Saraçët 5, 20000/Prizren
Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, 10000/Prishtinë
www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
038-224-967
029-222-771

PËRMBAJTJA

I. Hyrje	4
II. Monumentet e mbyllura të Prizrenit	4
III. Të gjeturat e monitorimit	6
Hamami i Gazi Mehmed Pashës	7
Hidroelektrana – Muzeu i Elektroekonomisë	8
Kisha Sinodale e Shën Gjergjit	9
Kisha e Shën Premtes – Levishka	10
Muzeu Arkeologjik – Sahat Kulla (Hamami i Shemsedin Ahmet Beut)	11
Muzeu i Nënë Terezës	12
Ndërtesa e Kuvendit të vjetër – Beledije	13
Selamllëku i Shani Efendiut	14
Shtëpia e Musa Shehzades	15
Shtëpia e Shuaip Pashë Spahiut	16
Rruga e Farkëtarëve	17
IV. Konkluzione	18
Referencat	19
EC Ma Ndryshe	20

I. Hyrje

Rreth 3 milionë euro janë shpenzuar brenda një periudhe jo të gjatë për restauarimin e dhjetë monumenteve të trashëgimisë kulturore në Prizren. Pothuaj të gjitha këto monumente sot janë të mbyllura për publikun. Në total, që nga përfundimi i punimeve restauruese, këto monumente kanë qëndruar të mbyllura prej 300 deri 350 muaj. Si rrjedhojë, ato kanë gjeneruar 0 euro nga aktiviteti eventual ekonomik. Për më keq, vetëm një nga këto dhjetë monumente ka plan të menaxhimit. Milionat e buxhetit të Kosovës dhe donatorëve ndërkombëtar për restauarime kanë prodhuar monumente të mbyllura, të cilat nuk po e ndalin trendin e degradimit të trashëgimisë kulturore të qytetit.

Përvoja ndërkombëtare sipas Bankës Botërore kanë treguar se vlerat e trashëgimisë kulturore dhe natyrore mund të shndërrohen në shtytës për Zhvillimin Ekonomik Lokal kur ka përpjekje të bashkërenduara dhe strategjike nga akterët kryesorë lokal, komuniteti, dhe nivelet e ndryshme të qeverisjes për të menaxhuar, zhvilluar dhe promovuar këto vlera në mënyrë të qëndrueshme dhe të koordinuar¹.

Në një publikim tjetër të Bankës Botërore vlerësohet se menaxhimi i aseteve të trashëgimisë mund të ofrojë një spektër të përfitimeve të shumta, të dallueshme dhe në rritje². Gjerësisht, ato mund të ndahen në ndikimet e mëdha ekonomike dhe jo-ekonomike. Ato ekonomike janë: ndikimet pozitive në uljen e varfërisë, rritjen e punësimit, shtimin e të ardhurave nga industritë e kulturës dhe shërbimeve, etj. Ndërsa ato jo-ekonomike janë ndikimet dobiprurëse në nivelet e edukimit dhe kultivimit të identitetit, në kohezionin social, përfshirjen dhe zhvillimin e kapitalit social, pastaj rritjen e vazhdueshme të trashëgimisë kulturore në nivel vendi, si dhe ruajtjen dhe përcjelljen e trashëgimisë në mënyrë të qëndrueshme të brezat e ardhshëm. Dhe që të dyja këto grupe përfitimesh apo ndikimesh janë shumë të rëndësishme³.

Hulumtuesit kanë vënë në pah se “ruajtja” dhe “menaxhimi” i monumenteve të trashëgimisë kulturore duhet të jenë komplementare. Pra, ruajtja është premisë thelbësore për menaxhim të mirë të trashëgimisë kulturore, por menaxhimi krijon vlera shtesë dhe shkon përtej duke i bërë monumentet e ruajtura më të qasshme për numër sa më të madh njerëzish. Kjo është arsyeja përse duhet pasur bashkëpunim ndërmjet menaxhimit të trashëgimisë dhe industrisë së turizmit⁴.

Trashëgimia kulturore ka vlerë të madhe për industritë e ndryshme. Por sektori i turizmit është industria që në masë më të madhe shfrytëzon trashëgiminë kulturore si mbështetje për aktivitetet kryesore të tij, si akomodimi, transporti dhe gastronomia⁵.

Në këtë prizëm, EC Ma Ndryshe ka ndërmarrë nismën për të analizuar ndikimet dhe përfitimet e intervenimeve disa milionëshe në monumentet e trashëgimisë kulturore në Prizren dhe në infrastrukturën në Qendrën Historike.

Rezultatet e këtij hulumtimi janë dekurajuese, për faktin se milionat e investuara gjatë dekadës së fundit në 10 monumente të trashëgimisë kulturore kanë prodhuar vetëm realitetin e dyerve të mbyllura për publikun vendor dhe vizitorët e huaj, me zero efekt ekonomik për qytetin dhe pothuajse asnjë dobi konkrete për komunitetin.

II. Monumentet e mbyllura të Prizrenit

EC Ma Ndryshe ka grumbulluar të dhëna për intervenimet restauruese-konservuese në këto objekte të trashëgimisë kulturore:

Hamami i Gazi Mehmed Pashës

Hidroelektrana – Muzeu i Elektroekonomisë

Kisha Sinodale e Shën Gjergjit

Kisha e Shën Premtes

Muzeu Arkeologjik – Sahat Kulla (Hamami i Shemsedin Ahmet Beut)

1 World Bank, Cultural Heritage and Local Economic Development: Good Practice from the Western Balkans, në linkun: http://www-wds.worldbank.org/external/default/WDSContentServer/WDSP/IB/2012/06/01/000426104_20120601141153/Rendered/PDF/690900WP0P10910Final0Synthesis0Note.pdf, qasur më 16 janar 2016

2 World Bank, Cultural Heritage and Development – A Framework for Action in the Middle East and North Africa, në linkun: <https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/13908/225590REPLACE-M1ccession0A2003100110.pdf?sequence=1&isAllowed=y>, qasur më 14 janar 2016

3 Po aty

4 Po aty

5 Directorate for Cultural Heritage, Norway, Cultural Heritage Monuments and Historic buildings as value generators in a post-industrial economy”, në linkun: http://brage.bibsys.no/xmlui/bitstream/handle/11250/175613/nypan_cultural_heritage.pdf?sequence=1, qasur më 15 janar 2016

Muzeu i Nënë Terezës

Ndërtesa e Kuvendit të vjetër – Beledije

Selamllëku i Shani Efendiut

Shtëpia e Musa Shehzades

Shtëpia e Shuaip Pashë Spahiut

Krahas tyre të dhënat janë mbledhur edhe për projektin e revitalizimit të rrugës së Farkëtarëve.

Komuniteti ndërkombëtar, Qeveria e Kosovës dhe Komuna e Prizrenit, në dekadën e fundit kanë shpenzuar afër **3 milionë euro** në projektet restauruese/konservuese në këto monumente.

Në bazë të monitorimit të aktiviteteve në këto monumente del se shumica e tyre i kanë dyert e mbyllura për publikun, apo nuk janë duke u shfrytëzuar për destinimin e caktuar sipas fondeve të ndara për intervenime. Shprehur në shifra dyert e këtyre monumenteve në total kanë qenë të mbyllura prej **300 deri 350 muaj**.

Shuma e mjeteve të gjeneruara nga aktiviteti eventual ekonomik në këto monumente deri tani është **0 euro**, derisa vetëm **1 prej tyre** ka plan menaxhimi, përkatësisht Hamami i Gazi Mehmed Pashës.

Restaurim me fonde të pamjaftueshme

Te rasti i Hamamit të Prizrenit, punimet restauruese patën nisur me mungesë mjeteve. Një parallogari e Qendrës Rajonale të Trashëgimisë Kulturore në Prizren pat bërë të ditur se shumica e nevojshme për intervenim është mbi 670 mijë euro. Për fazën e parë të këtyre punimeve UNESCO kishte ndarë 214 mijë dollarë. Prandaj ishte vendosur që në fazën e parë të intervenohet në kupola për të eliminuar rrezikun nga lagështia dhe degradimi i mëtutjeshëm i Hamamit. Por as mjetet e UNESCO-s nuk kanë qenë të mjaftueshme për përmbylljen e fazës së parë. Në mungesë të 50 mijë eurove, punimet janë ndërprerë qysh prej shtatorit të 2014-s. Ndërkohë në shkurt të 2015-s, plumbi nga pullazi i Hamamit është vjedhur në dy raste, duke rrezikuar kështu përsëri dëmtimin e monumentit nga ndikimi i lagështisë dhe degradimin e sërishëm të tij. Hamami është i vetmi monument që ka plan menaxhimi, por nuk funksionon në baza të rregullta. Përfundim bëjnë ngjarjet kulturore gjatë të cilave dyert e Hamamit hapen për kohë të shkurtër.

Muzeu pa aktivitet

Hidroelektrana – Muzeu i Elektroekonomisë është restauruar në sajë të mjeteve të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Projekti i restaurimit është hartuar nga Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore në Prizren dhe organizata Trashëgimia Kulturore pa Kufij. Punët restauruese kanë filluar në vitin 2012, dhe janë përmbyllur në vitin 2013. Planifikimi ka qenë që pas përfundimit të punëve restauruese, objekti të rikthehet në funksionin e Muzeut të Energjisë Elektrike, ndërkohë që brenda tij është rregulluar edhe një punëtori studimi. Mirëpo Muzeu i Elektroekonomisë deri më tani rrallë herë ka hapur dyert për aktivitetet, derisa as që bëhet fjalë për funksionim të përditshëm.

Kishat vetëm për klerikë e besimtarë

Kisha e Shën Gjergjit dhe ajo e Shën Premtes janë restauruar nga vitet 2005/06 e deri në 2010 përkatësisht 2014, me ndërprerje kohë pas kohe. Që të dyja i shërbejnë nevojave të klerit dhe besimtarëve e pelegrinëve ortodoks. Publiku apo turistët për vizitë duhet të marrin leje nga liderët fetarë të Kishës Ortodokse. Në të shumtën e rasteve përgjigjet janë negative.

Dy monumente, vetëm një roje

Muzeu Arkeologjik i Prizrenit – Sahat Kulla është restauruar së fundmi në sajë të mjeteve të Ambasadës Amerikane në Prishtinë, ndërkohë që vite më parë mjete pat ndarë edhe MKRS-ja. Ndonëse ky monument i dyfishtë është restauruar dhe ka gati gjithçka për funksionim të rregullt, megjithatë i ka dyert e mbyllura për publikun. Njëkohësisht për disa muaj ka qëndruar pa drejtues, derisa nuk ka staf që përkujdeset për vijimësinë e aktiviteteve të përditshme. I vetmi person i punësuar në këtë monument është përgjegjësi i sigurimit.

Shembull i “sakrificës” së fondeve

Muzeu i Nënë Terezës është një projekt i kontraktuar pesë vjet më parë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Ky muze ende nuk është vënë në funksion, ani pse sipas raporteve zyrtare punimet kanë përfunduar në vitin 2012. Në mesin e vitit të kaluar është dhënë edhe drita e gjelbër për pranimin teknik të objektit, por megjithëkëtë Muzeu sot e kësaj dite i ka të mbyllura dyert.

“Qendra Rajonale” e Drejtorisë së Turizmit

Ndërtesa e Kuvendit të vjetër – Beledije ishte restauruar gjatë viteve 2010–2011, në sajë të donacioneve të Zyres së Bashkimit Evropian në Kosovë, me destinimin që të jetë Qendër e parë Regjionale për Trashëgimi Kulturor në Ballkan. Mirëpo prej vitesh në këtë objekt është vendosur drejtoria për Turizëm e Komunës së Prizrenit.

Mashtrim i dyfishtë

Selamllëku i Shani Efendiut është restauruar në sajë të mbështetjes nga Fondi i Ambasadës Amerikane për Konservim. Punimet kanë përfunduar në vitin 2014. Realizimi i këtij projekti, pos kontributit për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, ka pas për synim, që njëri lokal, që është pronë e Komunës së Prizrenit, të vihet në funksion si Zyre Informativ Turistike, që do t'i jepte shtytje zhvillimit të turizmit dhe ekonomisë lokale. Me fondet e Qeverisë finlandeze, përmes UNDP-së, EC Ma Ndryshe ka rregulluar dhe pajisur në tërësi hapësirat e Zyres Informativ Turistike, bashkë me materiale promovuese turistike. Përkundër këtij fakti, ka më shumë se gjashtë muaj, që dyert e kësaj Zyreje Informativ Turistike mbeten të mbyllura, për shkak të dëshimit të Komunës së Prizrenit, për të caktuar personet që do të përkujdesej për aktivitetin e përditshëm të Zyres.

Monument i papërruar

Shtëpia e Musa Shehzades është restauruar në sajë të mbështetjes nga Fondi i Ambasadës Amerikane për Konservim. Punimet kanë përfunduar në vitin 2013. Plani ka qenë që brenda këtij monumenti të funksionalizohet Muzeu Etnologjik. Një gjë e tillë ende nuk ka ndodhur.

Akademia Diplomatike e Degradimit

Shtëpia e Shuaip Pashë Spahiut është rindërtuar nga Komuna e Prizrenit, duke mos i respektuar parimet për objektet e dëmtuara të trashëgimisë kulturore. As çështjet pronësore nuk janë zgjidhur. Madje investimet kanë nisur me planin që aty të krijohet një muze me ekspozate të Shuaip Spahiut dhe një pjesë të shërbej si galeri e arteve. Më pastaj ka qarkulluar ideja për muzeun e Bekim Fehmiut. Tek më pastaj, Komuna e Prizrenit ka marrë vendim që atë

t'ia japë në shfrytëzim Akademisë Diplomatike të Republikës së Kosovës. Mirëpo Akademia Diplomatike ende nuk është vendosur aty, për shkak të kontesteve gjyqësore mbi pronësinë. Ndërkohë zyrtarët e lartë komunal kanë pranuar se objekti nuk mirëmbahet dhe se ka degradim.

Farkëtimi i devijuar

Rruga e Farkëtarëve është një projekt i realizuar nga Komuna e Prizrenit dhe UN Habitatit. Punimet janë kryer në vitin 2011. Rruga është revitalizuar si përpjekje për lidhjen e Qendrës Historike me disa monumente të rëndësishme të trashëgimisë kulturore. Si e tillë parashihej që të jetë gjithmonë nën përkujdesje, e mirëmbajtur dhe e kalueshme për vizitorët dhe këmbësorët. Aktualisht ka mungesë të mirëmbajtjes së duhur, ndriçimi është jo-funksional, dhe sheshi i dedikuar për këmbësorë sërish është shndërruar në parking të automjeteve. Pra, në përgjithësi ka pamjen e një hapësire të degraduar. Ky projekt infrastrukturor është futur në këtë listë të monumenteve të analizuara për faktin se përbën vijën lidhëse ndërmjet tyre.

Kalaja e Prizrenit, si monument shumë i rëndësishëm arkeologjik, ku po ashtu janë investuar mjete të shumta, nuk është përfshirë në këtë analizë, për faktin se aktiviteti më i madh restaurues-konservues po zhvillohet tani, paralelisht me hartimin e Planit të menaxhimit. Mirëpo Kalaja e Prizrenit do të jetë objekt i një hulumtimi të ardhshëm të EC Ma Ndryshe, që do të koncentrohet në vetëm këtë monument.

III. Të gjeturat e raportit

Në vijim në formë tabelare janë paraqitur të gjitha të gjeturat e hulumtimit mbi monumentet e trajtuara, përfshirë: datën e restaurimit, shumën e restaurimit, donatorin, destinimin e menduar, shfrytëzimin momental, planin e menaxhimit, karakteristikat e monumentit, statusin e mbrojtjes, pronësinë, gjendjen momentale dhe infrastrukturën. Të dhënat faktike të kësaj analize janë grumbulluar nga institucionet përgjegjëse dhe organizata nuk garanton dhe nuk merr përgjegjësinë mbi saktësinë e qindpërqindtë të tyre.

Hamami i Gazi Mehmed Pashës

Data e restaurimit	Punimet filluan në gusht 2013, për të vazhduar deri në nëntor 2013. Pastaj filluan sërish në mars 2014 dhe u ndërpre në shtator 2014, për mungesë fondesh
Shuma e restaurimit	UNESCO për fazën e parë të restaurimit ka ndarë rreth 214 mijë dollarë amerikan. Sipas paramasës së QRTK në Prizren shuma e nevojshme ishte 670 mijë euro
Donatori	Qeveria e Turqisë, përmes UNESCO-s
Destinimi i menduar/planifikuar	Muze Hamami (pjesa për meshkuj e Hamamit) dhe Hapësirë multifunktionale kulturore (pjesa për femra e Hamamit) si galeri, punëtori artizanate, kafe-çajtoje, info qendra turistike, etj
Shfrytëzimi momental	I pashfrytëzuar. Ndonjëherë shërben si galeri për aktivitete kulturore, por vetëm pjesa e garderobës së Hamamit
Plani i menaxhimit	Ka plan menaxhimi, i cili është hartuar gjatë muajve korrik- shtator 2014, i sponsorizuar nga BE (Ljubljana Proce). Organizator ka qenë CHwB (Shqipëri), ndërsa prezantimi është bërë në nëntor 2014, në Budva të Malit të Zi
Rëndësia/Karakteristikat	Hamami është pjesë e ansamblit arkitektonik të krijuar nga Gazi Mehmed Pasha, në kuadër të cilit gjenden Xhamia e Bajraklisë, shkolla e mesme (medrese), shkolla fillore (mejtëpi), biblioteka dhe mauzoleu (tyrbja). Hamami i Gazi Mehmed Pashës është ndër objektet më të rëndësishme të arkitekturës osmane në Kosovë. Është i llojit “çifte hamam”, i dyfishtë, ka dy pjesë dhe është përdorur nga të dy gjinitë në të njëjtën kohë, me hyrje të veçanta dhe të ndarë
Statusi/ nr. vendimit	Ka status të mbrojtjes ligjore me numër 380/54
Pronësia	Bashkësia Islame (ndërtesa) dhe Komuna e Prizrenit (oborri)
Gjendja momentale	I pa shfrytëzuar dhe në gjendje të keqe. Restaurimi ka mbetur i papërfunduar. Mungesa e plumbit në një pjesë të pullazit rrezikon dëmtimin e mëtejshëm të objektit. Ka pas dy raste vjedhjesh të plumbit
Infrastruktura	Ekziston drenazhimi përreth Hamamit i cili është vendosur gjatë restaurimit të viteve 1960/70. Rryma merret nga shtylla elektrike në pjesën veri-perëndimore. Është provizore dhe e përkohshme, pra nuk mund të flitet për një instalim elektrik të mirëfilltë



Hidroelektrana – Muzeu i Elektroekonomisë

Data e restaurimit	Punimet kanë zgjatur nga viti 2012 deri në 2013
Shuma e restaurimit	123 mijë dollarë
Donatori	Ambasada Amerikane në Prishtinë
Destinimi i menduar/planifikuar	Muzeu i Elektroekonomisë dhe Punëtori studimi, hapësirë multifunkionale
Shfrytëzimi momental	I pa shfrytëzuar
Plani i menaxhimit	Nuk ka
Rëndësia/Karakteristikat	<p>Muzeu i Hidroelektranës “Prizrenasja” gjendet në kilometrin e 3-të të grykës së Lumbardhit. Është ndërtuar më 1929 buzë Lumbardhit. Është centrali i parë elektrik dhe muzeu i vetëm i Elektroekonomisë në Kosovë. Qytetin e furnizoi me energji elektrike 44 vjet, duke e ndërprerë punën më 1 nëntor 1973.</p> <p>Më 8 nëntor 1979 shndërrohet në Muze të Elektroekonomisë së Kosovës, ku u prezantuan shumë materiale origjinale dhe fotografi që pasqyrojnë zhvillimin e elektroekonomisë në Kosovë</p>
Statusi/ Nr. vendimit	Ka status të mbrojtjes ligjore me numër 50/77
Pronësia	Ministria e Kulturës – ORTK Prizren
Gjendja momentale	Punimet nuk kanë përfunduar siç është paraparë me projekt. Përveç punëve restauruese që nuk janë në tërësi të përfunduara, nuk është bërë asgjë në përgatitjen dhe krijimin e kushteve për hapjen e muzeut
Infrastruktura	Edhe pse ndërtesa i është nënshtruar restaurimit, instalimet nuk janë në tërësi të përfunduara. Por, në përgjithësi, instalimi plotëson nevojat elementare të ndërtesës



Kisha Sinodale e Shën Gjergjit

Data e restaurimit	Punimet në objekt filluan në shtator 2006 dhe zgjatën deri në shkurt 2009. Punimet në oborr përfunduan në vitin 2011
Shuma e restaurimit	1.23 milionë euro
Donatori	Ministria e Kulturës dhe donatorë ndërkombëtarë. Punimet janë realizuar përmes Komisionit për Implementimin e Rindërtimit
Destinimi i menduar/planifikuar	Kishë
Shfrytëzimi momental	Kishë
Plani i menaxhimit	Nuk ka
Rëndësia/Karakteristikat	Kisha Sinodale e Shën Gjergjit gjendet në qendër të qytetit, pason Sheshin e Shtatërvanit, rrugës për në Qafën e Pazarit. Objekti ka filluar të ndërtohet në vitin 1856 dhe ka përfunduar në vitin 1887. Është kishë tri anijatëshe, e ndërtuar me gur të gdhendur të lidhur me llaç gëlqeror, kurse pjesa e kambanores është ndërtuar me tullë. Kisha ka një fundament prej 30 x 20 m, dhe lartësia e saj arrin deri në 13.80 m. Pjesa e jashtme nuk është e suvatuar, ku vërehet mirë struktura e mureve. Për nga tipologjia i takon tipit të bazilikës me kupolë qendrore
Statusi/ nr. vendimit	Ka status të mbrojtjes ligjore me numër 02-956/64
Pronësia	Kisha Ortodokse Serbe
Gjendja momentale	Në gjendje të mirë
Infrastruktura	Në rregull



Kisha e Shën Premtes – Levishka

Data e restaurimit	Punimet kanë zgjatur nga korriku 2006 deri në shtator 2014 me ndërprerje kohë pas kohe
Shuma e restaurimit	410 mijë euro
Donatori	Ministria e Kulturës dhe donatorë ndërkombëtarë. Punimet janë realizuar përmes Komisionit për Implementimin e Rindërtimit
Destinimi i menduar/planifikuar	Kishë
Shfrytëzimi momental	E pa shfrytëzuar
Plani i menaxhimit	Nuk ka
Rëndësia/Karakteristikat	Kisha e Shën Premtes ka 7 faza ndërtuese ose rindërtuese: Faza e parë – Tempull romak shek. II-III, Faza e dytë – Bazilika trianijateshe e shek. V-VI, Faza e tretë – Bazilika mbi bazën e ndërtimit paraprak, shek. XI, Faza e katërt – Afreskat e zbuluara si “Zonja me Krishtin e vogël” dhe “Dasma në Kanë”, shek. XIII, Faza e pestë – Rindërtimi të mbretit serb Milutin, shek. XIV, Faza e gjashtë – Shndrimi i kishës në xhami, e cila u quajt Xhuma Xhamia, supozohet në shek. XV-XVI dhe Faza e shtatë – Pushtimi i Prizrenit nga serbet në vitin 1912 dhe rrënimi i minares dhe kthimi i kambanës dhe rikthimin e kishës. Kisha e Shën Premtes është objekti i vetëm i trashëgimisë kulturore të Prizrenit e cila është nën mbrojtje të UNESCO-s
Statusi/ nr. vendimit	Ka status të mbrojtjes ligjore me numër 352/48
Pronësia	Kisha Ortodokse Serbe
Gjendja momentale	Në gjendje relativisht të mirë
Infrastruktura	Pjesërisht e mirë



Muzeu Arkeologjik – Sahat Kulla (Hamami i Shemsedin Ahmet Beut)

Data e restaurimit	Dy restaurimet e fundit kanë ndodhur më 2008-2010, respektivisht më 2014-2015
Shuma e restaurimit	Investimi i Ministrisë së Kulturës në restaurim-konservim, në vitin 2008, ka kushtuar rreth 53 mijë euro. Restaurimi i vitit 2014 nga Ambasada Amerikane ka kushtuar 197 mijë dollarë
Donatori	Ministria e Kulturës dhe Ambasada Amerikane në Prishtinë
Destinimi i menduar/planifikuar	Muze Arkeologjik
Shfrytëzimi momental	I mbyllur për publikun. Pas restaurimit i gatshëm për shfrytëzim të shuman-shëm. Nuk ka menaxhment permanent e as aktivitete
Plani i menaxhimit	Nuk ka
Rëndësia/Karakteristikat	Hamami i Shemsedin Ahmet Beut është ndërtuar në shekullin XV, përkatësisht në vitin 1498. Nga mesi i shekullit XIX mbi hapësirën e ngrohtë të Hamamit është ndërtuar Sahat Kulla. Deri në vitin 1970, Hamami dhe Sahat Kulla përdorshin nga banorët e afërt si depo e vend mbeturinash, duke e dëmtuar në masë të madhe. Pas vitit 1970 fillojnë punimet për mbrojtjen e kësaj vlere të trashëgimisë dhe në vitin 1975 këtu hapet objekti me një destinim të ri, pra bëhet shndërrimi i hamamit në Muze Arkeologjik. Është muzeu i parë arkeologjik në Kosovë. Hamami i Shemsedin Ahmet Beut është ndër hamamet më të vjetra të Ballkanit dhe së bashku me Sahat Kullën përbëjnë ndër objektet më interesante dhe karakteristike të qytetit të Prizrenit
Statusi/ nr. vendimit	Ka status të mbrojtjes ligjore me numër 1263/68
Pronësia	Ministria e Kulturës – QRTK Prizren
Gjendja momentale	Kryesisht e mirë. Ka probleme me ndërtesa fqinje që ndikojnë në depërtimin e lagështisë. Kryesisht i mbyllur për publikun
Infrastruktura	Përgjithësisht është e mirë. Mungon ndriçimi i ekspozateve. Nuk ka parking të mjaftueshëm për muze



Muzeu i Nënë Terezës

Data e restaurimit	Punimet kanë zgjatur nga 2010 deri në 2012
Shuma e restaurimit	102 mijë euro
Donatori	Ministria e Kulturës
Destinimi i menduar/planifikuar	Muze
Shfrytëzimi momental	I pa shfrytëzuar dhe pa inventar
Plani i menaxhimit	Nuk ka
Rëndësia/Karakteristikat	Ndërtesa gjendet përballë Katedrales së Zonjës Ndhimëtare. Është ndërtesë e re, por destinimi i menduar do t'i jepte një rëndësi të veçantë këtij objekti. Muzeu kushtuar Nënë Terezë padyshim do të ishte një pjesë shumë e rëndësishme e mozaikut kulturor të Prizrenit
Statusi/ nr. vendimit	Në kuadër të Qendrës Historike të Prizrenit
Pronësia	Komuna e Prizrenit
Gjendja momentale	Duket se është në rregull. Ka prezencë të lagështisë, pasi ndërtesa është e mbyllur dhe nuk ka qarkullim të ajrit
Infrastruktura	Pasi muzeu nuk është në funksion dhe është i mbyllur, nuk dihet nëse ndërkohë diçka nga instalimet nuk janë në rregull



Ndërtesa e Kuvendit të vjetër (Beledija)

Data e restaurimit	Restaurimi ka zgjatur nga viti 2010 deri në 2011
Shuma e restaurimit	200 mijë euro
Donatori	Komisioni Evropian – ECLC
Destinimi i menduar/planifikuar	Qendër e parë Regjionale për Trashëgimi Kulturor në Ballkan
Shfrytëzimi momental	E shfrytëzuar për zyre administrative nga Drejtoria për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik, Komuna e Prizrenit
Plani i menaxhimit	Nuk ka
Rëndësia/Karakteristikat	Gjendet në kufirin perëndimor të Qendrës Historike të Prizrenit, në anën e djathtë të rrjedhës së Lumbardhit. Ndërtesa ka planimetri drejtkëndëshe. Karakterizohet me trajtim të pasur të fasadës me dekorime të plastikës murale. Enterieri i objektit karakterizohet me elemente të drugdhendjes në shtyllat e punuara, parmakët e shkallëve dhe favanet. Objekti i Beledijes është një ndërtesë publike, administrative e ndërtuar gjatë shekullit XIX dhe si e tillë ka vlerë të lartë historike, arkitekturore dhe artistike
Statusi/ nr. vendimit	Ka status të mbrojtjes ligjore
Pronësia	Komuna e Prizrenit
Gjendja momentale	Relativisht e mirë
Infrastruktura	E mirë



Selamllëku i Shani Efendiut

Data e restaurimit	Punimet restauruese kanë ndodhur gjatë viteve 2013 dhe 2014
Shuma e restaurimit	55 mijë dollarë
Donatori	Ambasada Amerikane, Komuna e Prizrenit, participimi i familjes
Destinimi i menduar/planifikuar	Banim, afarizëm, Info Qendër Turistike
Shfrytëzimi momental	Përdhesa shfrytëzohet për afarizëm, ndërsa kati është për banim, por momentalisht nuk shfrytëzohet. Info Qendra Turistike e pajisur me inventar dhe materiale promovuese, por Komuna e Prizrenit ka dështuar në sigurimin e aktivitetit ditor
Plani i menaxhimit	Nuk ka
Rëndësia/Karakteristikat	Shtëpia është dykatëshe. Në katin e parë ka dyqanin që ende vazhdon të ushroj veprimtarinë e briskagjiut. Në katin e dytë, shtëpia ka dy çardakë, të cilët dalin jashtë volumit të fasadës. Çardakët janë të ndryshëm, njëri është në formë katërkëndëshi, e tjetri në formë gjysmërrethore. Dy çardakët i japin formë karakteristike shtëpisë duke e shndërruar atë, në njëren prej më të bukura të Prizrenit
Statusi/ nr. vendimit	Ka status të mbrojtjes ligjore
Pronësia	Familja Shilik dhe Komuna e Prizrenit
Gjendja momentale	Ndërtesa është në gjendje të mirë pasi është restauruar në vitin 2014
Infrastruktura	Në rregull



Shtëpia e Musa Shehzades

Data e restaurimit	Restaurimi ka ndodhur në vitet 2012 dhe 2013
Shuma e restaurimit	55 mijë euro
Donatori	Ambasada Amerikane në Prishtinë dhe Komuna e Prizrenit
Destinimi i menduar/planifikuar	Muze Etnologjik
Shfrytëzimi momental	OJQ Numizmatika menaxhon me hapësirën muzeale të monumentit
Plani i menaxhimit	Nuk ka
Rëndësia/Karakteristikat	Shtëpia është ndërtuar në shekullin e XVIII. Përfaqëson kulmin e renesancës së arkitekturës folklorike, e cila ngërthen shumë elemente origjinale të arkitekturës vendase të Prizrenit. Në mes të shek. XX oborri i objektit përgjysmohet dhe ndërtohet një objekt i ri, duke e mbuluar gjysmën e fasadës së objektit në fjalë. Pas viteve 1980 objekti nuk shfrytëzohet për banim, por është shfrytëzuar si depo e materialit elektrik
Statusi/ nr. vendimit	Ka status të mbrojtjes ligjore me numër 615/55
Pronësia	Komuna e Prizrenit
Gjendja momentale	E mirë
Infrastruktura	Pasi është bërë restaurimi, respektivisht revitalizimi i ndërtesës për muze, janë rregulluar edhe instalimet. Nuk ka vend për parking



Shtëpia e Shuaip Pashë Spahiut

Data e restaurimit	Rekonstruimi total i shtëpisë ka ndodhur në vitet 2010 dhe 2011
Shuma e restaurimit	120 mijë euro
Donatori	Komuna e Prizrenit
Destinimi i menduar/planifikuar	Selia e Akademisë Diplomatike të Kosovës
Shfrytëzimi momental	I pa shfrytëzuar. Në kontest gjyqësor për pretendime pronësore
Plani i menaxhimit	Nuk ka
Rëndësia/ Karakteristikat	Shtëpia e Shuaip Pashës u ndërtua në fillim të shekullit XIX nga Shuaip Pashë Spahi, lider i degës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Shtëpia kishte vlera arkitektonike e folklorike si brenda ashtu edhe jashtë saj. Pas djegies dhe rrënimit total, është rindërtuar në vitin 2010-2011
Statusi/ nr. vendimit	Ka status të mbrojtjes ligjore me numër 957/64
Pronësia	Familja Kazazi, Perolli dhe Arënlju
Gjendja momentale	E pa shfrytëzuar dhe jo e kompletuar në enterier. Si pasojë e mos vënies në funksion ka nisur dëmtimi dhe degradimi
Infrastruktura	Pasi ndërtesa është rindërtuar instalimet janë rivendosur



Rruga e Farkëtarëve

Data e restaurimit	Punimet në revitalizimin e rrugës kanë zgjatur nga viti 2010 deri në 2011
Shuma e restaurimit	231 mijë euro
Donatori	UN Habitat dhe Komuna e Prizrenit
Destinimi i menduar/planifikuar	Shëtitore – vend rekreativ
Shfrytëzimi momental	I shfrytëzuar, por jo në formën e paraparë me projekt
Plani i menaxhimit	Nuk ka
Rëndësia/Karakteristikat	Rruga lidhet me Sheshin e Shatërvanit përmes Urës së Gurit. Në këtë rrugë ka shumë objekte të trashëgimisë kulturore me rëndësi të veçantë, si: Teqja Halveti, Selamllëku i Shani Efendiut, Kino Lumbardhi, Hamami i Gazi Mehmed Pashës, Xhamia e Kukli Beut.
Statusi/ nr. vendimit	Në kuadër të Qendrës Historike të Prizrenit
Pronësia	Komuna e Prizrenit
Gjendja momentale	Pa mirëmbajtje adekuatë. Kubëzat për pengimin e parkimit të automjeteve janë lëvizur nga vendi. Ndiriçimi i dëmtuar dhe i riparuar. Parkimi i veturave vazhdon ta degradojë këtë hapësirë
Infrastruktura	Trupat ndriçues janë të dëmtuara. Blloqet janë të zhvendosura. Ulëset janë të amortizuara



IV. Konkluzione

Milionat e investuara gjatë dekadës së fundit në 10 monumente të trashëgimisë kulturore kanë prodhuar vetëm realitetin e dyerve të mbyllura për publikun vendor dhe vizitorët e huaj, me zero efekt ekonomik për qytetin dhe pothuajse asnjë dobi konkrete për komunitetin, pos konservimit fizik të monumentit, edhe kjo e fundit me defekte në raste të caktuara.

Për shkak të mungesës së qasjes së lehtë në to, në përgjithësi këto monumente nuk kanë mundur të sjellin përfitime ekonomike dhe jo-ekonomike për qytetin dhe komunitetin. Madje nuk është arritur të krijohet një aktivitet i qëndrueshëm që së paku do të ishte i dobishëm për nxënësit dhe studentët në kuadër të sistemit të tyre të shkollimit. Ndërkohë që edhe rastet me kishat ortodokse tregojnë se as që mund të bëhet fjalë në këtë stad për ndikimin pozitiv në kohezionin social.

Të gjitha këto të gjetura dëshmojnë se niveli lokal dhe qendror i qeverisjes, ani pse në planet e veta strategjike e vendosin si shtyllë të rëndësishme të zhvillimit edhe trashëgiminë kulturore dhe turizmin, megjithatë në realitet nuk kanë ide e plane sesi ta jetësojnë këtë konkretisht në funksion të përfitimit të vërtetë ekonomik. Rrjedhimisht mjete të shumta të buxhetit shpenzohen e nuk kthehen si dobi të dyfishuara për taksapaguesit. Ekzistimi i vetëm një plani të menaxhimit të 10 objekte të trashëgimisë kulturore është dëshmi e mjaftueshme për këtë.

Në këtë aspekt, praktikat e mosfunksionalizimit të monumenteve të trashëgimisë kulturore mund të jenë dekura-juese edhe për donatorët ndërkombëtarë. Prandaj, në këtë pikë edhe vet donatorët duhet të kushhtëzojnë mbështetjen e projekteve restauruese-konservuese me ekzistimin e planeve të menaxhimit për monumentet e trashëgimisë kulturore.

Referencat

A. Ahmedi, Theranda - Prizreni ndër shekuj, Prizren 1996

Directorate for Cultural Heritage, Norway, Cultural Heritage Monuments and Historic buildings as value generators in a post-industrial economy

E. H. Ayverdi, Avrupa'da Osmanlı mimari eserleri - Yugoslavya - kitap III, Istanbul 2000

E. Shukriu, Kisha e Shën Premtes në Prizren, Prishtinë 1993

EC Ma Ndryshe dhe gjashtë komnatat e rajonit të Prizrenit, Bukur dhe Gjellbër - Katalogu i rajonit Jug, Prizren 2015

F. Drançolli, Trashëgimia Monumentale në Kosovë

I. Zdravković, Adaptacija amama u Prizrenu za muzej i galeriju slika, Starine Kosova II-III, Prishtinë 1963

Komuna e Prizrenit, Prizreni Vendtakim i Civilizimeve, Prizren 2012

M. Osi, Prizreni qytet i lashtë, muze me thesar të pasur kulturor, Prizren 2001

M. Shukriu, Prizreni i Lashtë - morfologjia e ecurive për ruajtjen e kulturës materiale, Prizren 2001

Muhamed Shukriu, Prizreni i Lashtë, Morfologjia e ecurive për ruajtjen e kulturës materiale, Prizren 2001

P. Kostić, Crkveni život pravoslavnih srba u Prizrenu i njegovoj okolini u XIX veku, Beograd 1928

Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore, Prizren

R. Virmiça, Kosovada Osmanli mimari eserleri 1, Ankara 1999

S. Nikolić, Prizren od srednjeg veka do savremenog doba, Prizren 1998

Shpresë Siqeca, Arkitektura Folklorike e Prizrenit dhe e Malishevës, Prizren 2011

Shpresë Siqeca, Perlat e Etnisë Shqiptare në Prizren, Prizren 2002

V. Shtylla, Ndërtimet e hershme hidraulike shqiptare, Tiranë 2009

World Bank, Cultural Heritage and Development - A Framework for Action in the Middle East and North Africa

World Bank, Cultural Heritage and Local Economic Development: Good Practice from the Western Balkans

EC Ma Ndryshe

EC është organizatë e komunitetit, e themeluar në vitin 2006, që angazhohet për avansimin e demokracisë në nivel lokal në Kosovë. Organizata punon me një numër të konsiderueshëm grupesh të komunitetit, si dhe mirëmban një presion të përhershëm ndaj qeverive lokale për qeverisje gjithëpërfshirëse, transparente dhe llogaridhënëse. EC angazhohet për qytetari aktive në formësimin e ambientit jetësor duke nxitur organizim të mirëfilltë të komunitetit, demokratizim të institucioneve dhe pasurim të jetës kulturore në qendrat kryesore të Kosovës, me fokus në Prizren dhe Prishtinë. Nga janari i vitit 2015, EC funksionon me këto tri programe: Qyteti Gjithëpërfshirës (mobilizim i komunitetit), Qeverisja e mirë (monitorim dhe avokim), Hulumtimi (prodhim i dijes)

Tiparet dalluese të EC janë: një, fokusi gjeografik, dhe dy, qasja ndaj çështjeve të interesit. E bazuar në Prizren dhe Prishtinë, organizata përdor qasje antropologjike në hulumtimin dhe zhvillimin e politikave. Si rezultat, produktet e hulumtimit të organizatës ofrojnë përmbajtje të besueshme, pasi që merren me thelbin e problemit në vend se me simptomat. Për më tepër, EC mbulon fusha të veçanta sikur planifikimi urban, politikën kulturore, menaxhimi i hapësirës publike dhe të ngjashme, të cilat janë përgjithësisht të nëntrajtuara në Kosovë. Aktiviteti hulumtues dhe aktivizmi grassrootsi i organizatës janë metoda pune të kombinuara mirë dhe të ndërvarura. Përmes aktivizmit, EC angazhohet në mënyrë të përhershme në punë me grupet e komunitetit për t'i identifikuar nevojat e tyre, të cilat janë burime që e ushqejnë komponentën e hulumtimeve. Kjo metodologji mundëson ndikim më të madh tek agjenda e politikëbërjes, pasi që idetë vijnë nga poshtë, ndërsa paralelisht krijohen mundësi për përfshirjen e politikëbërësve në një debat konstruktiv dhe të mirëinformuar.

Projektet kryesore të organizatës gjatë viteve të fundit: EC për qytete transparente dhe gjithëpërfshirëse (2015-2016), Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale (2015-2016), Urbanizmi I Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm (2013-2016), Aktivizmi kulturor dhe urban në Prizren (2014-2015), Qyteti Gjithëpërfshirës, planifikim me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren (2013-2015), Lidhja e komunitetit me shërbyesit e drejtësisë (2014-2016), Zhvillimi rajonal përmes turizmit kulturor (2014-2015), Pjesëmarrja qytetare përmes medias sociale (2013-2015), Trashëgimia kulturore, shtyllë qendrore e zhvillimit lokal dhe rajonal në Prizren

(2013-2015), Pjesëmarrja publike në hartimin e politikave kulturore në Prizren (2012-2013), Transparenca Online e komunave të Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës (2012-2015), Një tregim ballkanik (2011-2012), Aktivizmi qytetar për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore (2009-2010).

Publikimet e fundit të organizatës: Një qytet për komunitetin (2015), Katalogu i Rajonit Jug “Bukur dhe Gjellbër” (2015), Zhdukja e Gjurmëve - Qendrat historike të Kosovës (2015), Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore (kontribut për raportin e Progresit) (2015), (Pa)drejhtësia në urbanizmin e Prizrenit (2015), Grupet e komunitetit dhe planifikimi urban në Prizren (2015), Katalogu i Rajonit të Prizrenit (2015), Planifikim urban për qytetarët (2014), Qendra Historike e Prishtinës numëron ditët e fundit (2014), Ku është kall-drëmi i Prizrenit? (2014), Paraja publike si “paret e babës” (2014), Udhëzues për transparencën në komuna (2014), Ligjet nuk po e mbrojnë Qendrën Historike të Prizrenit (2014), Urbanizmi si lexim i qytetit (2014).

